



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 806/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Vlladimir Branković paraqitur përshkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 11.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**HIDHET si e pasafatshme** ankesa e Vlladimir Brankovićit.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 08.11.2013, nga Vlladimir Brankovićit, në të cilën pretendon se në vendvotimin në vendvotimin Suvi Dol nr.3804b/1 kryesuesi i vendvotimit ka lëshuar vendvotimin së bashku me kolegët e tij Boshnjačka i Srpska Partija në ora 17:30. Menjëherë pas asaj vëzhguesit e OSBE-së kanë lëshuar vendvotimin në panik dhe kanë thënë se duhet të largohemi nga ky vendvotim dhe se policia do ti siguronë kutitë. Andaj parashtruesi i ankesës kur e ka pyetur prestarin e policisë së Kosovës se kush do ti sigurojë kutitë ai i ka thënë se nuk dinte dhe se kjo nuk është detyra e tyre dhe se vendvotimi në fjalë është lëshuar në ora 17:38. Parashtruesi i ankesës më tutje thekson se ju është thënë që të gjithë ta lëshojnë vendvotimin së bashku me vëzhguesit dhe se OSBE-ja do ti përsëris këto zgjedhje në Suvi Dol.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmerinë e ankesës gjeti se:

**Ankesa është e pasafatshme**

PZAP-i konsideron se ankesa në fjalë është e pasafatshme pasi që neni 119.1 i LZP-së parasheh që personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas

këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë një ankesë pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetedy (72) orëve nga koha kur është pranuar ankesa, andaj ngjarja për të cilin pretendon pala ankuese ka ndodhur me datën 03.11.2013, ndërsa ankesa në PZAP është dorëzuar me datën 08.11.2013 çka nënkupton se ka kaluar afati i paraparë prej 24 orë për dorëzimin e ankesës në PZAP, prandaj në kuptim të nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe nenit 119.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 806/2013 më datën 11.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



**Këshillë juridike:** *PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*